



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.33 dt.14.02.1997

MBI

DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN NENTOR 1996

Në bazë të legjislacionit të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt.14.02.1997, pasi shqyrtoi dhe relacionin e Zyrës së Asistencës Sociale

V E N D O S I;

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **11.710 familje** me një fond prej **29.515.196 lekë**. Për çdo Njësi Administrative sipas relacionit.
2. Miratohet masa e ndihmës ekonomike për çdo familje për muajin nëntor .
3. Të bëhet pranimi i dokumentacionit të plotë sipas ligjit dhe dosjeve të personave me aftësi të kufizuar për familjet e dy lagjeve të Komunës Sauk që në bazë të VKM Nr.526, dt.12.08.1996 kalojnë në Njësinë Administrative Nr.2.
4. Të rifuten në skemën e ndihmës ekonomike Lulëzim Kulla familje me 4 antarë ndihmë ekonomike e plotë Njësia Administrative Nr.5
5. Nuk përfiton ndihmë ekonomike familja e Ndoc Gasprit dhe të kthejë lekët që ka marrë padrejtësisht për 1 vit në Njësinë Administrative Nr.2, për vitin 1995.
6. Të trajtohen në mënyrë të diferencuar brenda kufijve ligjore Elida Borici familje me 2 antarë ndihmë ekonomike e plotë Nj.A.4, Lirika Dhamo familje me 1 antar ndihmë ekonomike e plotë Nj.A.4.
7. Të dalin nga skema e ndihmës ekonomike **245 familje** sipas pasqyrave të bashkëngjitura.
8. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **1334 persona** me aftësi të kufizuar dhe **47 persona** për përkujdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar me një fond gjithsej prej **6.203.756 lekë**. Për çdo njësi Administrative sipas relacionit.
9. Nuk miratohet kërkesa e Estref Sinellës për të përfituar ndihmë ekonomike.

**K R Y E T A R I
ORHAN SAKIQI**

